



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit – Ured Premijera – Office of the Prime Minister

**RAPORT NGA PROCESI I KONSULTIMIT PËR STRATEGJINË PËR RREGULLIM
MË TË MIRË 2.0 PËR KOSOVËN (2017-2021) DHE PLANIN E VEPRIMIT TË
STRATEGJISË**

Prishtinë, 2018

Hyrje

Nga muaji mars i vitit 2018, Sekretariati Koordinues i Qeverisë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (SKQ), ka filluar rishikimin e Strategjisë për Rregullim më të Mirë 2.0 për Kosovën. Në këtë drejtim, SKQ ka zhvilluar procesin e konsultimeve paraprake dhe konsultimeve me publikun sipas Rregullores Nr. 05/2016 për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik dhe sipas dispozitave përkatëse të Rregullores Nr. 09/2011 e Punës së Qeverisë.

Versioni i përditësuar i Strategjisë integron zotimet të cilat Kosova i ka ndërmarrë në kuadër të Kontratës së Reformës Sektoriale për Reformën e Administratës Publike dhe objektivat e ndërlidhura për të cilat është angazhuar Qeveria përmes indikatorëve të Përkrahjes Buxhetore Sektoriale (PBS). Kjo kontratë dhe Marrëveshja e ndërlidhur financiare kanë hyrë në fuqi më 15 dhjetor të vitit 2017. Përderisa kjo kontratë nuk ka ndikuar në objektivat e strategjisë, ka nxitur nevojën për të përshtatur disa tregues, afate kohore dhe rrjedhimisht Planin e Veprimit.

Përveç kësaj, IFC-ja ka riorientuar përkrahjen e saj drejt përmirësimit të vendimmarrjes së bazuar në fakte gjatë fazës ex-ante. Organizata ka zhvendosur fokusin e saj drejtë përkrahjes së vlerësimit legjislativ dhe thjeshtimit të licencave dhe lejeve.

Të gjitha këto që u cekën më lartë, ishin shtytës të inicimit të rishikimit të Strategjisë me qëllim adresimin e tyre në kuadër të Strategjisë dhe Planit të Veprimit.

Ecuria e procesit të konsultimit

Konsultimet për Strategjinë dhe Planin e Veprimit kanë nisur që nga faza e hershme e rishikimit ku janë konsultuar palët të e përfshira në proces. Në këtë kuadër, Strategjia gjithashtu është dërguar për konsultim paraprak me 27 mars të vitit 2018, ndërsa ministritë e linjës dhe institucionet publike kishin afat prej 15 ditëve për të ofruar komente.

Autoritetet që dhanë komente dhe sugjerime ishin:

1. Zyra Ligjore e Kryeministrit;
2. Agjencia për Barazi Gjinore; dhe
3. Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Me datë 10 Maj të vitit 2018, SKQ ka bërë publikimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit në platformën online të konsultimeve me publikun por në këtë proces SKQ nuk ka

pranuar komente dhe sugjerime. Dokumenti i shoqërues i Konsultimit në formë të shkurtër ka paraqitur informatat e përmbledhura nga Strategjia, qëllimin e rishikimit, hapësirën për konsultim, informatat për hapat pas përfundimit të procesit të konsultimit etj.

Konsultimi i realizuar përmes takimeve dhe shpërndarjes së dokumentit dhe pastaj publikimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit, kanë qenë mjete të mjaftueshme për të marrë kontributet nga ana e palëve të interesit, duke marrë gjithashtu parasysh edhe natyrën e tyre dhe interesat që prek Strategjia.

Metodat e Konsultimit	Datat/kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve/kontribuesve
1. Konsultimet me shkrim / në mënyrë elektronike;	15 ditë pune	3 Kontribues nga Institucionet e Qendrës së Qeverisë dhe Ministrinë e linjës
2. Publikimi në ueb faqe/Platforma elektronike	15 ditë pune	0 Kontribues

Përmbledhje e kontributeve të pranura gjatë procesit të konsultimit

Kontributet për Strategjinë janë dhënë kryesisht gjatë procesit të konsultimit me shkrim, ndërsa kontribute përmes platformës online të konsultimeve publike, nuk ka pasur.

Çështje tjera

Të gjitha kontributet e pranura janë shqyrtuar veç e veç nga Sekretariati Koordinues i Qeverisë. Raporti i detajuar për komentet e pranura, kontribuesit dhe statusin e kontributeve janë paraqitur në formë të plotë në shtojcën nr. 1 të këtij raporti.

Hapat e ardhshëm

Strategjia për Rregullim më të Mirë 2.0 për Kosovën dhe Plani i Veprimit është finalizuar dhe sipas dispozitave përkatëse të Rregullores së Punës së Qeverisë do të procedohet tutje për shqyrtim dhe miratim në Qeverinë e Kosovës.

Shtojca 1 – tabela e detajuar me informatat për kontribuesit, arsyetimet për përgjigjet e pranuar dhe të refuzuara

Organizata	Komenti	Data e komentit	Marrë parasysh: po, pjesërisht, jo	Shpjegimi
Agjencia e Statistikave të Kosovës	<p>F. 7-8</p> <p>Komenti:</p> <p>Të nderuar,</p> <p>Kjo çështje nuk është në fushëveprimin dhe mandatin e ASK-së pasi ka të bëjë me rritjen e efikasitetit, respektivisht zvogëlimin e barrës administrative në lëshimin e lejeve dhe licencave. Sidoqoftë, në diskutime me partnerët tjerë duhet të merren parasysh edhe efektet anësore. Për shembull, ASK, si pjesë e administratës publike/shtetërore në fushën e saj të veprimtarisë, për të përmbushur mandatin e saj, kërkon të dhëna më shumë se një herë brenda një viti nga familjet, bizneset, të cilat ndonjëherë mund të kërkojnë nëpërmjet dokumenteve ose strategjive të ndryshme që kanë qëllim krejtësisht tjetër.</p> <p>Komenti ynë lidhet me faqen e përgjithshme të objektivit 8, duke iu referuar dokumentit: Qeveria e Kosovës mbetet e përkushtuar ndaj parimeve për zbatimin e duhur të politikave dhe legjislacionit. Në mënyrë të veçantë, këto janë: (1) “një raport për përdorim të shumëfishtë” që siguron se qytetarët, kompanitë, organizatat e shoqërisë civile dhe të</p>	15-04-2018	JO	Strategjia për Rregullim më të Mirë nuk e trajton këtë çështje në veçanti. Nuk është e nevojshme të bëhen ndryshime në këtë parim.

	<p>tjerët <u>duhet të ofrojnë informata për administratën vetëm një herë dhe se ato informata janë të qasshme dhe mund të përdoret edhe nga palët tjera në kuadër të administratës [P1];</u></p> <p>Për shembull, ASK si pjesë e administratës publike/shtetërore në fushën e saj të veprimtarisë, për të përmbushur mandatin e saj, kërkon të dhëna më shumë se një herë brenda një viti nga familjet, bizneset,</p>			
Zyra Ligjore, ZKM	<p>F. 11 Sugjerim për fshirje të fjalisë: OSBE kërkoi një referencë më të qartë në draft Ligjin aktual për Aktet Normative. Referenca për procesin e parashikuar të konsolidimit në këtë draft është shtuar në strategji.</p>	17-04-2018	PO	Komenti është integruar në dokument.
	<p>F. 24 Zëvendësoni “aktet normative” me “aktet juridike”</p>	17-04-2018	PO	Komenti është integruar në dokument. Fjala “aktet normative” zëvendësohet me fjalën “aktet juridike”.

	<p>F. 36 Sugjerim për të shtuar tekstin në lidhje me vlerësimin ex-post:</p> <p>Vlerësimi ex-post duhet të dallohet nga funksioni monitorues i Kuvendit ose i Parlamentit; i pari është proces vetëvlerësimi i bërë nga qeveria në politikat dhe rezultatet e saj, ndërsa ky i fundit është funksioni i mbikëqyrjes parlamentare, p.sh. <i>(Shih nenin 4.4 të Kushtetutës, i cili parasheh që Qeveria "është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar". Shih gjithashtu nenin 6.9 dhe 47 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, roli mbikëqyrës i Kuvendit dhe autoriteti i Komisioneve për monitorimin e zbatimit të ligjeve.)</i></p> <p>Në fund, vlerësimi ex-post ndihmon qeverinë të vlerësojë ndikimin e ligjit në mungesë të një vlerësimi ex-ante.</p>		PO	<p>Komenti është integruar në dokument, me një përshtatje të vogël në fjalinë e fundit.</p> <p><u>Fjalja e fundit është riformuluar si në vijim:</u> Së fundi, vlerësimi ex-post ndërlihet me vlerësimin e ndikimit të ligjit gjatë procesit të ciklit të politikave.</p>
	<p>F. 36 Në SRRM 2.0 aktuale specifikohet që Kosova në korrik 2015 ka miratuar [...]</p> <p>ZL ka propozuar që të specifikojë si në vijim: Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 03/38, me datë 15.07.2015 ka miratuar [...]. "Ky udhërrëfyes përcakton" në gjuhën shqipe fjala përcakton mungon, prandaj ZL sugjeron të shtohet teksti si në vijim: Ky udhërrëfyes, mes tjerash, përcakton se si duhet të kryhet</p>		PO	<p>Komenti është integruar në dokument.</p>
	<p>F. 36 ZL sugjeron që të shtohet teksti në vijim: Zyra Ligjore në kuadër të ZKM-së, në bashkëpunim me ministrinë e linjës, do të kryejë një program vlerësimi ex post çdo vit. ZL-ja në bashkëpunim me IFC do të ofrojë trajnime për zyrtarët në zhvillimin e vlerësimeve. Bazuar në draft Marrëveshjen e Bashkëpunimit që pritet të përfundohet nga Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC), është përgatitur një Plan Veprimi për ngritjen e</p>		PO	<p>Komenti është integruar në dokument.</p>

	<p>kapaciteteve për vlerësime në Institucionet Qendrore (2018 dhe 2019). Zyra Ligjore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (ZKM) dhe ekipi i IFC u dakorduan që të gjitha grupet e aktiviteteve që mund të të ndërtojnë kapacitetet e vlerësimit pas zbatimit të realizohen brenda kornizës së bashkëpunimit ndërmjet ZL-së dhe IFC-së, në kuadër të marrëveshjes së përcaktuar.</p> <p>Programi i Trajnimit të Projektit të IFC-së do të mbulojë disa elemente që lidhen me vlerësimin ex-post të legjislacionit, duke filluar nga arsyetimi dhe llojet kryesore të vlerësimit në aspektet e ndërlidhura organizative dhe procedurale.</p> <p>Duke iu referuar shprehimisht Udhëzimit të Qeverisë për vlerësimin ex-post, aktivitetet e trajnimit do të zgjerojnë këto udhëzime dhe do t'i plotësojnë ato me njohuri metodologjike të përshtatura dhe praktike, si dhe me mjete analitike, për të ndihmuar zyrtarët qeveritarë në zhvillimin e të gjitha fazave të procesit të vlerësimit.</p>			
Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ)	<p>F. 27-28</p> <p>Në figurën 6 Analiza e integruar ex ante dhe ex-post e politikave nga Komisioni Evropian, pas tekstit Metodologjia e integruar e vlerësimit të ndikimit - që mbulon ndikimet ekonomike, mjedisore dhe sociale të shtohet gjithashtu: vlerësimin e ndikimit gjinor.</p> <p>Një pyetje tjetër e parashtruar nga ABGJ: “Në pasaportën e treguesve nuk përmendet ABGJ dhe pasi që ekziston vlerësimi i ndikimit gjinor, mendojmë se institucioni duhet të jetë diku / Si mendoni ta bëni këtë?”</p>	17-04-2018	JO	<p>Strategjia për Rregullim më të Mirë, në veçanti figura 6, i referohet analizës ex ante dhe ex-post të politikave nga Komisioni Evropian. Ata (<i>Komisioni i BE-së</i>) i referohen ndikimeve ekonomike, mjedisore dhe sociale, pa iu referuar ndikimeve tjera të tilla si barazia gjinia, etj. Nëse përfshihet vlerësimi i ndikimit gjinor, atëherë është e nevojshme që të zgjerohet fusha e ndikimeve dhe të përfshihet Testi i NVM-ve dhe ndikimet tjera.</p> <p>Treguesit e pasaportës janë zhvilluar në vitin 2016 dhe nuk mund të ndryshohen për momentin. Ky propozim mund të përfshihet në afatin e mesëm kur të rishikohen treguesit.</p>